URDHËR
Nr. 91, datë 25.7.2023

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të nenit 21, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ligjit nr. 10296, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, të udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2023, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.1.2023, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", si dhe të nenit 24 të rregullores "Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit" dhe të nenit 6 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e administratës së KPK-së",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, te Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, z. Edmond Verçani, për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla apo direkte, si dhe veprimet me Degën e Thesarit Tiranë, për këto prokurime.
2. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri, deri më 31.12.2023.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimet Mbështetëse për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Roland Ilia